

**A. 2 (dy) vende pune për personel akademik të kategorisë asistent-lektorë në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit për lëndët:**

**Kandidati i 1:**

*Në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni:*

- *Sensorët dhe Shndërruesit 1 (ushtrime, detyra kursi, laboratore);*
- *Sensorët dhe Shndërruesit 2 (laboratore);*
- *Elektronikë Fuqi (ushtrime, detyra kursi, laboratore);*
- *Matjet Elektronike (ushtrime, detyra kursi, laboratore).*

**Kandidati i 2:**

*Në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni:*

- *Transmetimet numerike (ushtrime, detyra kursi, laboratore);*
- *Elementet dhe Teknologjitë Elektronike (ushtrime, detyra kursi, laboratore);*
- *Elektronikë Fuqi (ushtrime, detyra kursi, laboratore)*
- *Matjet Elektronike (ushtrime, detyra kursi, laboratore).*

**Kandidatët për personel akademik në kategorinë “Asistent-lektorë” pranë Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të zotërojnë diplomë të sistemit 5 vjeçar ose sistemit 3 + 2 (Bachelor +Master i Shkencave) të studimeve në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit (UPT) në fushën e Inxhinierisë Elektronike ose Inxhinierisë së Telekomunikacionit;
2. Të kenë notë mesatare të studimeve Bachelor + Master i Shkencave  $\geq 8$  (më e lartë ose e barabartë me 8) dhe notë  $\geq$  në lëndët specifike;
3. Të zotërojnë dëshminë/certifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet gjuha angleze dhe niveli C;
4. Preferohet të kenë botime të artikujve në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe kod ISSN, si dhe Referime Shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings me kod ISBN. Artikujt dhe referimet shkencore do të vlerësohen të tilla vetëm në rast të lidhjes së tyre me fushën e Inxhinierisë së Elektronikës dhe/ose Telekomunikacionit, si tregues për fushën e ardhshme kërkimore-shkencore të kandidatit.
5. Të kenë eksperiencë pune në mësimdhënie pranë institucioneve të arsimit të lartë, të dëshmuar me referenca;
6. Të kenë kryer trajnime të ndryshme në fushën e elektronikës dhe telekomunikacionit;
7. Të ketë dy rekomandime nga personeli akademik i FTI, UPT me titull Profesor ose Profesor i Asociuar, ose nga departamenti përkatës (i fakultetit/universitetit respektiv) ku kandidati ka kryer studimet, me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit, specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në DET, FTI.

**B. 2 (dy) vende pune për personel akademik të kategorisë asistent-lektorë në Departamentin e Inxhinierisë Informatike për lëndët:**

- *Bazë të dhënash (Seminar + Laborator) në Bachelor Inxhinieri Informatike;*
- *Sisteme operative (Seminar + Laborator) në Bachelor Inxhinieri Informatike;*
- *Arkitektura e Kompjuterave (Seminar + Laborator) në Bachelor Inxhinieri Informatike;*
- *Siguria e Sistemeve (Seminar + Laborator) në Master Profesional Inxhinieri Informatike.*

**Kandidatët për personel akademik në kategorinë “Asistent-lektorë” pranë Departamentit të Inxhinierisë Informatike në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të zotërojnë diplomë të sistemit 5 vjeçar ose sistemit 3 + 2 (Bachelor +Master i Shkencave) të studimeve në fushën e Inxhinierisë Informatike ose profile të ngjashme;
2. Të kenë notë mesatare të studimeve Bachelor + Master i Shkencave  $\geq 8.5$  (më e lartë ose e barabartë me 8) dhe notë 9 ose 10 në lëndët specifike ku do të angazhohet përkatësisht: Bazë të dhënash, Sisteme operative/Arkitektura e kompjuterave, Siguria e sistemeve;
3. Të zotërojnë dëshminë/certifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet gjuha angleze dhe niveli C1;
4. Preferohet të kenë botime të artikujve në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe kod ISSN, si dhe Referime Shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings me kod ISBN.
5. Preferohet të kenë eksperiencë pune në mësimdhënie pranë institucioneve të arsimit të lartë, me kohë të plotë ose të pjesshme;
6. Të ketë dy rekomandime nga personeli akademik i FTI, UPT me titull Profesor ose Profesor i Asociuar, me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit, specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në DII, FTI.

**C. 2 (dy) vende pune për personel ndihmësakademik (Laborant) në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit.**

**Kandidatët për personel ndihmësakademik pranë Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të zotërojnë minimalisht diplomë të ciklit 3 vjeçar Bachelor në programet e FTI (Inxhinieri Elektronike, Informatike, Telekomunikacion) apo edhe në fusha të ngjashme;
2. Preferohet të zotërojnë dëshminë/certifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj.
3. Të kenë aftësi të mira komunikimi si dhe aftësi të punës në grup. Preferohet dëshira për rritje profesionale dhe inovacion.
4. Të kenë një letër rekomandimi nga staf akademik i Universitetit/Fakultetit ku kandidati ka kryer studimet, me datë jo më të hershme se data e shpalljes së njoftimit të punësimit.

**II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Dokumentin e fitimit të gradës shekncore “Doktor”;
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.